

L I G J
Nr. 9587, datë 20.7.2006

PËR MBROJTJEN E BIODIVERSITETIT

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi

Ky ligj synon:

1. Të sigurojë mbrojtjen dhe ruajtjen e diversitetit biologjik.
2. Të rregullojë përdorimin e qëndrueshëm të përbërësve të diversitetit biologjik, nëpërmjet integritit të elementeve kryesore të biodiversitetit në strategjitë, planet, programet dhe vendimmarrjet e të gjitha niveleve.

Neni 2

Përkufizime

Në kuptim të këtij ligji, me termat e mëposhtëm nënkuptohet:

1. “Biodiversitet (diversitet biologjik) ose larmi biologjike” është shumëllojshmëria e organizmave të gjallë të të gjitha llojeve, duke përfshirë, ndër të tjera, ekosistemet tokësore, detare dhe ekosistemet e tjera ujore, si dhe komplekset ekologjike, ku ato bëjnë pjesë. Ky term përfshin shumëllojshmërinë brenda dhe ndërmjet llojeve dhe shumëllojshmërinë e ekosistemeve.

2. “Bioteknologji” është çdo zbatim teknologjik, që përdor sistemet biologjike, organizmat e gjallë apo derivatet e tyre, për të prodhuar a modifikuar produkte ose procese për përdorim të veçantë.

3. “Bioteknologji moderne” është zbatimi i teknikave in vitro të acidit nukleik, duke përfshirë acidin dezoksiribonukleik (ADN) dhe injektimin e drejtpërdrejtë të acidit nukleik në qelizë apo organellë ose i shkrirjes së qelizave përtej familjes taksonomike, që tejkalon barrierat e riprodhimit fiziologjik apo të rikombinimit dhe që nuk janë teknika të përdorura në kryqëzimet dhe përzgjedhjen tradicionale.

4. “Burime gjenetike” janë materiale gjenetike, me vlerë aktuale apo potenciale.

5. “Ekosistem” është një kompleks dinamik, i përbërë nga komitete të bimëve, kafshëve e mikroorganizmave, si dhe mjedisi jo i gjallë, të cilat ndërveprojnë ndërmjet tyre si një njësi funksionale.

6. “Gjenom” është tërësia e materialit gjenetik, që gjendet në një organizëm të gjallë.

7. “Habitat” është mjedisi i disa individëve, bimorë ose shtazorë, i popullatave ose i bashkësive të tyre.

8. “Introduktim i qëllimshëm” është futja në një mjedis e një lloji të huaj apo e një organizmi gjenetikusht të modifikuar, që kryhet dhe/ose përfshin një lëvizje të qëllimshme, të kryer nga njerëzit. Për llojet e huaja, kjo përfshin një lëvizje të qëllimshme të një lloji jashtë

shtrirjes së vet natyrore dhe potencialit të përhapjes.

9. “Introduktim i paqëllimshëm” është futja e paqëllimshme e një lloji të huaj ose e një organizmi të modifikuar gjenetiki, që i përdor njerëzit apo sistemet e shpërndarjes së njeriut si vektorë për përhapje. Për llojet e huaja, introduktimi i paqëllimshëm është jashtë potencialit të përhapjes.

10. “Kampion mjedisor” janë mostrat e ujit, të tokës, ajrit apo materialeve të tjera fizike.

11. “Ligatina” janë sipërfaqet kënetore, moçalore, turbishte apo sipërfaqet ujore, natyrore ose artificiale, të përhershme ose të përkohshme, me ujë të fjetur ose të rrjedhshëm, të ëmbël, të kripur, përfshirë dhe sipërfaqet e ujërave detare, thellësia e të cilave, në zbatim, nuk i kalon 6 metrat. Ligatinat përcaktohen nga komunitetet e tyre biologjike dhe nga karakteristikat e tyre hidrologjike dhe që, në varësi të situatës, nga karakteristikat e tyre gjeografike, të tilla si tipi i tokës.

12. “Leje mjedisore” është dokumenti zyrtar i miratimit të një veprimtarie me ndikim në mjedis, i lëshuar në përputhje me kushtet e përcaktuara në ligjin nr.8934, datë 5.9.2002 “Për mbrojtjen e mjedisit”.

13. “Lista e kuqe” është renditja e llojeve sipas rrezikut të prekjës nga zhdukja, në mbështetje të klasifikimit të përpunuar nga Qendra Botërore e Ruajtjes së Natyrës.

14. “Lloj ose specie” është një njësi taksonomike, ku bëjnë pjesë bimë, kafshë ose mikroorganizma taksonë më të ulët ose popullatat e tyre.

15. “Lloj i huaj” është një kafshë, bimë apo mikroorganizëm, që ndodhet jashtë shtrirjes natyrore dhe potencialit të përhapjes dhe përfshin çdo pjesë ose gamet, që mund të mbijetojë dhe të riprodhohet.

16. “Lloj i huaj invaziv” është një lloj i huaj, që zë vend në ekosisteme, habitate ose peizazhe, a që vepron si një faktor ndryshimi dhe kërcënon mjedisin, shëndetin e njeriut ose zhvillimin e qëndrueshëm.

17. “Material gjenetik” është çdo material nga një organizëm i gjallë ose jo i gjallë, që përmban njësitë funksionale të trashëgimisë.

18. “Molekulë biologjike” është tërësia e lëndëve, të thjeshta e të përbëra, organike, që janë pjesë përbërëse e gjallesave, ku përfshihen proteinat, acidet nukleike, karbohidratet dhe yndyrnat.

19. “Organizëm i gjallë” është çdo entitet biologjik, i aftë të transferojë apo shumëzojë materialin gjenetik, ku përfshihen edhe organizmat sterilë dhe viruset.

20. “Organizma gjenetiki të modifikuar (OMGJ)” është çdo organizëm i gjallë, që zotëron një ndërthurje të re të materialit gjenetik, që përftohet nëpërmjet përdorimit të bioteknologjisë moderne.

21. “Peizazh” është një hapësirë siç perceptohet nga njerëzit, karakteri i së cilës është rezultat i veprimit dhe i ndërveprimit të faktorëve natyrorë dhe/ose njerëzorë.

22. “Përbërës të larmisë biologjike” janë ekosistemet, organizmat e gjallë ose pjesë të tyre, burimet gjenetike a çdo përbërës tjetër biotik i ekosistemeve me përdorim ose vlerë aktuale apo potenciale për njerëzimin.

23. “Përdorim” është zotërimi, tregtimi i çdo lloji, i formave jetësore ose i pjesëve a derivateve të tij dhe përpjekjet për t'u përfshirë në veprime të tilla.

24. “Përdorim i qëndrueshëm” është përdorimi i përbërësve të biodiversitetit në një mënyrë dhe një ritëm, që nuk çon në zvogëlimin afatgjatë të biodiversitetit, duke mirëmbajtur potencialin e tij, për të plotësuar nevojat dhe aspiratat e brezave të sotëm dhe të ardhshëm.

25. “Raca dhe varietete të rëndësishme për ushqim dhe bujqësi” janë racat e kafshëve e varietetet e bimëve të vendit dhe burimet gjenetike të lidhura me to, që përdoren për ushqim, bujqësi dhe mjedise të tjera prodhuese.

26. “Ruajtje ex-situ” janë masat menaxhuese, të nevojshme për ruajtjen e llojeve dhe të burimeve të tyre gjenetike shoqëruese, jashtë ekosistemeve apo habitateve të tyre natyrore. Për racat e varietetet autoktone, të rëndësishme për ushqim dhe bujqësi, kuptohet ruajtja jashtë

mjediseve të prodhimit, ku ato kanë zhvilluar karakteristikat e tyre dalluese.

27. “Ruajtje in-situ” janë masat menaxhuese, të nevojshme për të ruajtur ekosistemet dhe habitatet e për të mirëmbajtur ose për të restauruar popullatat e llojeve, që mund të jetojnë në habitatet e tyre. Për racat dhe varietetet autoktone, të rëndësishme për ushqim dhe bujqësi, kuptohet ruajtja brenda mjediseve të prodhimit, ku ato kanë zhvilluar karakteristikat e tyre dalluese.

28. “Status ruajtjeje i një ekosistemi, habitati apo peizazhi” është tërësia e ndikimeve, që veprojnë në një ekosistem, habitat apo peizazh dhe llojet tipike, që mund të ndikojnë në shpërndarjen, strukturën, funksionet natyrore dhe mbijetesën afatgjatë të llojeve tipike.

29. “Status ruajtjeje i një lloji” është tërësia e ndikimeve, që veprojnë në llojet e interesuara, që mund të ndikojnë në shpërndarjen dhe prurjen afatgjatë të popullatave të veta.

30. “Statusi i favorshëm i ruajtjes së një ekosistemi, habitati apo peizazhi” është kur:

a) shtrirja natyrore dhe sipërfaqet, që mbulon brenda kësaj shtrirjeje, janë të qëndrueshme ose në rritje;

b) strukturat dhe funksionet e veçanta, të cilat janë të nevojshme për mirëmbajtjen e vet afatgjatë, janë të pranishme dhe mund të vazhdojnë të ekzistojnë në të ardhmen e afërt;

c) llojet e tij tipike kanë një status ruajtjeje të favorshëm.

31. “Statusi i favorshëm i ruajtjes së një lloji” është kur:

a) të dhënat e dinamikës së popullatës për një lloj të interesuar tregojnë, se ai mbetet për një kohë afatgjatë një përbërës, i vlefshëm dhe i aftë i habitateve të veta natyrore;

b) shtrirja natyrore e llojeve nuk është zvogëluar dhe as nuk ka mundësi të zvogëlohet në të ardhmen e afërt;

c) është dhe ndoshta do të vazhdojë të jetë një habitat i mjaftueshëm, nga madhësia, për të mbajtur popullatat për një afat kohor të gjatë.

32. “Statusi i pafavorshëm i ruajtjeve” është:

a) për llojin, kur nuk plotësohet çdonjëri prej kushteve të parashikuara në pikën 31 të këtij neni;

b) për ekosistemet, habitatet dhe peizazhet, kur nuk plotësohet çdonjëri prej kushteve të parashikuara në pikën 30 të këtij neni.

33. “Shfrytëzim” është gjuajtja, vrasja, dëmtimi, kapja, mbledhja, vjelja, çrrënjosja, shkulja, prerja, shkatërrimi, përpunimi, ballcamimi, transporti, konsumimi, tregtimi ose largimi i një lloji, i formave të tij jetësore, pjesëve apo derivateve të veta, si dhe orvatjet për t'u angazhuar në këto veprime.

34. “Shtrirje natyrore” është mjedisi, që një lloj zë në mënyrë natyrore, si në të kaluarën dhe në të tashmen.

35. “Ministria” është Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, si dhe çdo institucion i strukturuar në vazhdim të saj.

36. “Ministër” është Ministri i Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave.

37. “Zhvillim i qëndrueshëm” është sipas kuptimit të dhënë në pikën 25 të nenit 3 të ligjit nr.8934, datë 5.9.2002 “Për mbrojtjen e mjedisit”.

38. “Rrjeti përfaqësues i zonave të mbrojtura” është sipas kuptimit të dhënë në pikën 17 të nenit 3 të ligjit nr.8906, datë 6.6.2002 “Për zonat e mbrojtura”.

39. “Informacion ekzistues” janë të dhënat për biodiversitetin, që janë të disponueshme nga publiku dhe të botuara në dokumentet zyrtare.

40. “Informacion i ri” janë të dhënat për biodiversitetin, që nuk janë botuar ose shpërndarë zyrtarisht dhe që vlerësohen nga specialistët si risi shkencore.

41. “Përdorime ose shfrytëzime të mëparshme” janë përdorime ose shfrytëzime të lejuara përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, të cilat mund të përdoren edhe pas hyrjes në fuqi të ligjit.

42. “Përdorime ose shfrytëzime të reja” janë përdorime ose shfrytëzime, që lejohen pas hyrjes në fuqi të ligjit.

Neni 3
Fusha e zbatimit

1. Ky ligj zbatohet:
- a) për të gjitha sipërfaqet gjeografike, tokësore, ujore dhe detare të Republikës së Shqipërisë, pronë shtetërore apo private;
 - b) për të gjithë përbërësit e diversitetit biologjik, që gjenden në mjediset e përmendura në shkronjën “a” të pikës 1 të këtij neni.
 - c) nga organet shtetërore, që veprojnë në kuadër të këtij ligji apo të ligjeve të tjera të kësaj fushe, nga personat fizikë dhe juridikë, publikë e privatë, vendas dhe të huaj, veprimtaritë e të cilëve kanë ndikim në biodiversitet, si dhe nga organizatat shoqërore dhe nga publiku.
2. Materiali gjenetik dhe organizmat gjenetikisht të modifikuar (OMGJ-të) nuk janë objekt i këtij ligji.

KREU II
INSTITUCIONET PËR RUAJTJEN DHE MBROJTJEN E BIODIVERSITETIT

Neni 4
Institucionet shtetërore

1. Republika e Shqipërisë, për mbrojtjen dhe ruajtjen e larmisë biologjike:
- a) ushtron të drejtat sovrane për përbërësit e diversitetit biologjik, që gjenden në sipërfaqet e veta tokësore, ujore dhe detare;
 - b) përdor përbërësit e diversitetit biologjik në mënyrë të qëndrueshme për brezat e sotëm dhe të ardhshëm;
 - c) siguron që veprimtaritë brenda juridiksionit të vet nuk dëmtojnë biodiversitetin tej kufijve shtetërorë dhe në territoret e shteteve të tjera.
2. Republika e Shqipërisë bashkëpunon me shtete dhe organizata ndërkombëtare për ruajtjen e diversitetit biologjik dhe për përdorimin e qëndrueshëm të përbërësve të tij, veçanërisht për:
- a) përbërësit e përbashkët ose ndërkufitarë të diversitetit biologjik;
 - b) ndikimet ndërkufitare të veprimtarive, që ushtrohen në territorin e saj;
 - c) përballimin e situatave emergjente;
 - ç) përmbushjen e detyrimeve, që burojnë nga marrëveshjet ndërkombëtare, në të cilat ajo është palë.

Neni 5
Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave

Ministria është institucioni qendror përgjegjës për ruajtjen e biodiversitetit dhe për përdorimin e qëndrueshëm të përbërësve të tij, në nivel kombëtar dhe vendor.

Neni 6
Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit

Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit është autoriteti drejtues dhe përgjegjës për të siguruar ruajtjen dhe përdorimin e qëndrueshëm të racave dhe të varieteteve autoktone, të rëndësishme për ushqim dhe bujqësi.

Neni 7
Organe të tjera

Organet shtetërore, qendrore dhe vendore, që sipas ligjeve të veçanta administrojnë burime natyrore përbërëse të biodiversitetit, e mbrojnë atë, duke vepruar në kuadër të këtij funksioni.

KREU III INSTRUMENTET E PLANIFIKIMIT TË BIODIVERSITETIT

Neni 8

Strategjia dhe plani i veprimit të biodiversitetit

1. Për mbrojtjen e biodiversitetit hartohet strategjia kombëtare dhe plani i veprimit të biodiversitetit, kërkesat e të cilëve zbatohen nga organet shtetërore dhe personat fizikë e juridikë. Ky dokument miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit.

2. Kërkesat e strategjisë dhe të planit të veprimit të biodiversitetit harmonizohen me këtë ligj e me ligje të tjera të mbrojtjes së mjedisit, si dhe ndihmojnë në zbatimin e tyre.

3. Strategjia e biodiversitetit rinovohet çdo 10 vjet.

4. Ministria drejton punën për hartimin dhe rinovimin e strategjisë dhe të planit të veprimit të biodiversitetit, duke siguruar pjesëmarrjen e të gjitha grupeve të interesuara, të organeve shtetërore, qendrore dhe vendore, komunitetit shkencor dhe shoqërisë civile.

5. Përparësitë dhe kërkesat e përcaktuara në strategjinë dhe në planin e veprimit të biodiversitetit të përfshihen në strategjitë, planet, programet sektoriale dhe në vendimmarrjet e organeve shtetërore, në nivel kombëtar dhe vendor.

Neni 9

Rrjeti i inventarizimit dhe i monitorimit të biodiversitetit

1. Për ruajtjen e biodiversitetit dhe përdorimin e qëndrueshëm të përbërësve të tij ngrihet rrjeti i inventarizimit dhe i monitorimit të biodiversitetit, si burim kryesor informacioni për të mbështetur vendimmarrjet në të gjitha nivelet.

2. Kriteret dhe procedurat për ngritjen e këtij rrjeti, mënyra e funksionimit dhe detyrat e tij, si dhe organet e institucionet, që ngarkohen me ngritjen dhe administrimin e tij, miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit.

Neni 10

Planifikimi për emergjencat

Ministria, në bashkëpunim me strukturat e tjera shtetërore, të ngarkuara për emergjencat natyrore:

a) harton plane dhe procedura veprimi për menaxhimin e rasteve të papritura nga veprimtaritë njerëzore ose nga ndodhitë natyrore, që mund të kërcënojnë biodiversitetin, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë ose në zonat ndërkufitare;

b) njofton shtetet potencialisht të rrezikuara dhe organizatat ndërkombëtare përkatëse në rastet e rrezikut ose të dëmtimit, të shpejtë ose të rëndë, të biodiversitetit dhe bashkëpunon me to për të parandaluar apo zvogëluar kërcënimet e shfaqura.

Neni 11

Ndikimet ndërkufitare

Kur ndikimet negative rrezikojnë diversitetin biologjik të një shteti fqinj, ministria njofton, shkëmben të dhëna dhe këshillohet me shtetin e interesuar, si dhe vlerëson kërkesat e tij

përpara se të japë lejen mjedisore.

KREU IV
RUAJTJA E EKOSISTEMEVE, HABITATEVE DHE PEIZAZHEVE, QË NDODHEN
JASHTË RRJETIT PËRFAQËSUES TË ZONAVE TË MBROJTURA

Neni 12

Ruajtja

1. Ekosistemet, habitatet dhe peizazhet ruhen edhe kur ndodhen jashtë rrjetit përfaqësues të zonave të mbrojtura, pronë publike apo private.

2. Ruajtja e ekosistemeve, habitateve dhe peizazheve, që ndodhen jashtë rrjetit përfaqësues të zonave të mbrojtura, përfshin:

- a) ekosistemet, habitatet dhe peizazhet e mbrojtura;
- b) ekosistemet, habitatet dhe peizazhet veçanërisht të mbrojtura;
- c) ekosistemet, habitatet dhe peizazhet e degraduara.

Neni 13

Identifikimi

1. Kategoritë e përgjithshme të ekosistemeve, habitateve dhe peizazheve të mbrojtura përfshijnë ligatinat dhe zonat e tjera me ndjeshmëri të lartë mjedisore, që identifikohen për të marrë një status të përshtatshëm ruajtjeje.

2. Në ekosistemet, habitatet dhe peizazhet veçanërisht të mbrojtura përfshihen ato:

- a) me status ruajtjeje të pafavorshëm;
- b) me diversitet të lartë e numër të madh llojesh, endemike apo të egra;
- c) që popullohen nga llojet veçanërisht të mbrojtura;
- ç) që kërkohen e përdoren nga llojet shtegtare;
- d) që janë të rëndësishme për vetitë natyrore, shkencore, kulturore apo social-ekonomike;
- dh) që janë përfaqësuese unike apo të lidhura me proceset kyçe të zhvillimit ose me procese të tjera biologjike;
- e) të shpallura si të tilla në bazë të instrumenteve ndërkombëtare, në të cilat Republika e Shqipërisë është palë.

3. Në ekosistemet, habitatet dhe peizazhet e degraduara përfshihen ato, të cilat janë të ndotura, të mbishfrytëzuara dhe të shkatërruara, modifikimi i të cilave ka ulur, në mënyrë të ndjeshme, aftësinë e funksioneve dhe të proceseve të tyre, si dhe aftësinë për të mbajtur popullata autoktone, të afta për të jetuar.

4. Ekosistemet, habitatet dhe peizazhet individuale, që kërkojnë mbrojtje të veçantë, identifikohen me qëllim që t'u sigurohet statusi i favorshëm i ruajtjes, ndërsa ato të degraduara identifikohen me qëllim që të rehabilitohen dhe të kthehen në gjendje natyrore.

5. Identifikimi bëhet duke u mbështetur në të dhënat e reja dhe ato ekzistuese, në strategjinë dhe planin e veprimit të biodiversitetit, në rrjetin e inventarizimit e të monitorimit të diversitetit biologjik dhe burimet ndërkombëtare të të dhënave.

6. Për ekosistemet, habitatet dhe peizazhet e mbrojtura apo veçanërisht të mbrojtura, si dhe për ato të degraduara, ministria harton dhe mban regjistrat kombëtarë përkatës.

7. Ministri miraton formatin, kërkesat për regjistrim, çregjistrim dhe kriteret e përdorimit të regjistrave.

8. Ministria merr masa për mbrojtjen dhe menaxhimin e këtyre zonave, përpara regjistrimit në regjistër dhe përpara zbatimit të planit të menaxhimit e të veprimit për to.

Neni 14

Përdorimet e mëparshme

Veprimtaritë apo përdorimet e mëparshme të një ekosistemi, habitati apo peizazhi do të vazhdojnë të ushtrohen edhe pas hyrjes në fuqi të këtij ligji. Ministria dhe organet e tjera, të përcaktuara me ligj për administrimin e tyre, marrin masa për të siguruar se këto veprimtari apo përdorime janë në përputhje me statusin e favorshëm të ruajtjes, që kanë ose që mund të rimarrin ekosistemet, habitatet e peizazhet, duke iu nënshtruar procedurave të vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe pajisjes me leje mjedisore.

Neni 15

Veprimtari ose përdorime të reja

Veprimtaritë ose përdorimet e reja në ekosisteme, habitate dhe peizazhe të mbrojtura mund të ushtrohen vetëm pasi t'u jenë nënshtruar procedurave të vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe të jenë pajisur me leje mjedisore.

Neni 16

Masat e menaxhimit

1. Brenda 7 vjetëve nga miratimi i këtij ligji, ministria dhe Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, në bashkëpunim me organe të tjera shtetërore dhe vendore, me organizatat jofitimprurëse mjedisore dhe me persona juridikë dhe fizikë, hartojnë planet e menaxhimit, për të mbajtur apo rivendosur statusin e favorshëm të ruajtjes së ekosistemeve, habitateve a peizazheve të mbrojtura, të ekosistemeve, habitateve apo peizazheve veçanërisht të mbrojtura, si dhe të atyre të degraduara, të cilat miratohen nga ministri dhe Ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

2. Objektivat dhe kërkesat e planeve të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni integrohen në strategji, plane, programe dhe në vendimmarrje, në nivel kombëtar dhe vendor, jo më vonë se dy vjet pas miratimit të tyre.

Neni 17

Mbrojtja dhe menaxhimi vullnetar

Pronarët privatë ose grupe të tjera të interesuara mund të hyjnë në marrëveshje me organin shtetëror përkatës për të mbrojtur dhe menaxhuar një pronë, me ndihmën teknike, financiare dhe organizative të shtetit, për të mbajtur apo për t'i kthyer ekosistemit, habitatit a peizazhit statusin e favorshëm të ruajtjes.

KREU V

MASAT MBROJTËSE PËR LLOJET (SPECIET) TOKËSORE, UJORE DHE DETARE

Neni 18

Fusha e veprimit

Llojet në këtë kre nuk përfshijnë racat dhe varietetet e rëndësishme për ushqim dhe bujqësi, llojet e huaja dhe llojet e huaja invazive.

Neni 19

Ruajtja dhe përdorimi

1. Ruajtja dhe përdorimi i qëndrueshëm i llojeve dhe habitateve të tyre është pjesë e

politikave, planeve, programeve dhe vendimmarrjes shtetërore, në nivel kombëtar dhe vendor.

2. Ruajtja dhe përdorimi i qëndrueshëm i llojeve dhe habitateve të tyre kushtëzohet nga mbajtja apo rivendosja e statusit të favorshëm të ruajtjes për llojin në habitatin e vet.

3. Organet shtetërore, personat juridikë, publikë dhe privatë dhe personat fizikë marrin masa dhe shmangin dëmtimet e panevojshme të llojeve dhe habitateve të tyre, brenda dhe jashtë zonave të mbrojtura.

4. Ruajtja e llojeve përfshin llojet e mbrojtura dhe llojet veçanërisht të mbrojtura.

Neni 20

Statusi i llojeve të mbrojtura

1. Kapja, marrja, mbajtja dhe përdorimi i individëve të llojeve të kafshëve dhe bimëve të mbrojtura janë të ndaluara, përveç rasteve kur në këtë ligj përcaktohet ndryshe.

2. Me propozimin e ministrit, Këshilli i Ministrave miraton, me vendim, listën e llojeve të mbrojtura të vendit.

3. Llojet e këtij grupi mund t'u nënshtrohen masave menaxhuese dhe përdorimit në gjendje natyrore të rregulluar në ligj, që do të bëhet në përputhje me statusin e ruajtjes së favorshme. Mbështetur në të dhënat e marra nga rrjeti i inventarizimit dhe monitorimit të diversitetit biologjik, në masa të tilla mund të përfshihen:

a) rregullimet, që lidhen me aksesin në prona të caktuara;

b) ndalimi, i përkohshëm ose lokal, i nxjerrjes së llojeve në natyrë dhe shfrytëzimi i popullatave të caktuara;

c) rregullimi i periudhave dhe/ose metodave të marrjes së llojeve;

ç) zbatimi i rregullave të gjuetisë dhe të peshkimit, të cilat marrin parasysh ruajtjen e këtyre popullatave;

d) vendosja e një sistemi licencimi për përdorimin e llojeve ose të kuotave të vjeljes;

dh) rregullimi i blerjes, shitjes, ofertës për shitje, mbajtjes për shitje ose transportit për shitje të llojeve e individëve;

e) kontrolli i shumimit në gjendje jo të lirë të llojeve të kafshëve, si dhe shumimi artificial i llojeve bimore në kushte të rrepta kontrolli, për pakësimin e marrjes së llojeve nga gjendja e egër;

ë) vlerësimi i efektit të masave të marra.

Neni 21

Shfrytëzime ose përdorime të reja për llojet e mbrojtura

Shfrytëzime apo përdorime të reja të individëve të llojeve të kafshëve dhe bimëve të mbrojtura lejohen të ushtrohen kur nuk cenojnë statusin e ruajtjes së llojeve të kërcënuara, kur janë miratuar nga ministri dhe kur janë pajisur me leje mjedisore. Këto përdorime ose shfrytëzime lejohen për:

a) qëllime shkencore apo edukimi;

b) ruajtje ex-situ, për masa përzgjedhëse ose qëllime riintroduktimi;

c) materiale gjenetike;

ç) të mbrojtur diversitetin biologjik;

d) shëndetin, sigurinë dhe qëllime turistike;

dh) masa sanitare apo fitosanitare.

Neni 22

Identifikimi i llojeve veçanërisht të mbrojtura

1. Llojet, që kërkojnë mbrojtje të veçantë, identifikohen me qëllim që t'u ruhet ose t'u

jepet statusi i favorshëm i ruajtjes.

2. Identifikimi bëhet në bazë të të dhënave të reja dhe atyre ekzistuese, të siguruara nga strategjia e biodiversitetit, plani i veprimit, rrjeti i inventarizimit dhe monitorimit të diversitetit biologjik, si dhe nga burime të tjera të mundshme.

3. Ministria harton dhe administron regjistrin e llojeve veçanërisht të mbrojtura, ku përfshihen, në radhë të parë, llojet që:

- a) kanë një status ruajtjeje të pafavorshëm;
- b) janë endemike;
- c) për të cilat ka të dhëna të pamjaftueshme;

ç) janë shpallur veçanërisht të mbrojtura, në bazë të instrumenteve ndërkombëtare, ku Republika e Shqipërisë është palë.

4. Format i regjistrin dhe kriteret e përdorimit të tij miratohen me udhëzim të ministrit.

5. Institucionet kërkimore-shkencore hartojnë listën e kuqe, si dokumenti ku pasqyrohet statusi i ndryshëm i llojeve të rrezikuara në vend. Ky dokument rinovohet çdo 5 vjet dhe miratohet me urdhër të ministrit.

Neni 23

Statusi i për mbrojtjen e llojeve veçanërisht të mbrojtura

1. Ndalohen të shfrytëzohen ose të përdoren individët e kafshëve dhe të bimëve veçanërisht të mbrojtura, me përjashtim të rastit kur me ligj parashikohet ndryshe. Këto ndalime zbatohen për të gjitha fazat e jetës së kafshëve dhe për të gjitha fazat e ciklit biologjik të bimëve.

2. Llojet e bimëve veçanërisht të mbrojtura i nënshtrohen një regjimi të rreptë mbrojtjeje, duke ndaluar:

- a) mbledhjen e qëllimshme, prerjen, shkuljen ose shkatërrimin e këtyre bimëve në zonën e tyre natyrore, në gjendje të egër;
- b) mbajtjen, transportin, shitjen, shkëmbimin ose ofertën për shitje a shkëmbim të këtyre llojeve, të marra në gjendje të egër.

3. Llojet e kafshëve veçanërisht të mbrojtura i nënshtrohen një regjimi të rreptë mbrojtjeje në zonën e tyre natyrore të përhapjes, duke ndaluar:

- a) të gjitha format e kapjes së qëllimshme ose vrasjen e këtyre llojeve;
- b) shqetësimin e qëllimshëm të këtyre llojeve, veçanërisht gjatë periudhës së shumimit, rritjes, dimërimit dhe shtegtimit;
- c) shkatërrimin e qëllimshëm ose marrjen e vezëve të tyre;
- ç) dëmtimin ose shkatërrimin e zonave të shumimit ose të vendeve të qëndrimit;
- d) mbajtjen, transportin, shitjen, shkëmbimin ose ofertën për shitje a shkëmbim të këtyre llojeve, të marra në gjendje të egër.

Neni 24

Shfrytëzime ose përdorime të mëparshme për llojet veçanërisht të mbrojtura

1. Ministria dhe organet e tjera, të përcaktuara me ligj për administrimin e llojeve veçanërisht të mbrojtura, marrin masa për të siguruar që përdorimet ose shfrytëzimet e mëparshme të llojeve veçanërisht të mbrojtura të jenë në përputhje me statusin e favorshëm të ruajtjes së tyre.

2. Përdorimet ose shfrytëzimet e mëparshme pajisen me leje mjedisore vetëm kur janë në përputhje me statusin e ruajtjes së llojeve veçanërisht të mbrojtura.

Neni 25

Shfrytëzime ose përdorime të reja për llojet veçanërisht të mbrojtura

1. Shfrytëzimet ose përdorimet e reja të individëve të kafshëve e të bimëve veçanërisht të mbrojtura, që paraqiten në rastet e përcaktuara në nenin 21 të këtij ligji, pajisen me leje mjedisore nëse:

- a) nuk ka alternativa të tjera të kënaqshme;
- b) janë në përputhje me statusin e favorshëm të ruajtjes së llojit;
- c) nuk bien ndesh me detyrimet ndërkombëtare të Republikës së Shqipërisë;
- ç) nuk bien ndesh me objektivat e planit të veprimit të llojit, për llojet me status të pafavorshëm ruajtjeje.

2. Shfrytëzimi ose përdorimi i rastësishëm i llojeve veçanërisht të mbrojtura është i ndaluar.

Neni 26

Menaxhimi

1. Për llojet veçanërisht të mbrojtura, të regjistruara me status ruajtjeje të pafavorshëm, ministria, në bashkëpunim me organet shtetërore, qendrore e vendore, institute të specializuara, organizata jofitimprurëse dhe me persona fizikë e juridikë, harton planet e veprimit për ruajtjen e llojit. Këto plane miratohen me udhëzim të ministrit.

2. Planet e veprimit për ruajtjen e llojit përfshihen në strategjitë, planet, programet dhe në vendimmarrjet shtetërore, në nivel kombëtar dhe vendor.

3. Planet e menaxhimit dhe të veprimit për habitatet e llojeve veçanërisht të mbrojtura, me status të pafavorshëm ruajtjeje, përgatiten si pjesë e planeve të veprimit për ruajtjen e llojit.

4. Në planet e veprimit përcaktohen hollësisht masat e menaxhimit, për t'i mbajtur llojet në një status të favorshëm ruajtjeje ose për t'ua dhënë këtë status, kur nuk e kanë.

5. Në hartimin e planeve të veprimit për ruajtjen e llojit, përbën përparësi fakti se sa i kërcënuar është një lloj, sipas përcaktimit të bërë në nenin 22 të këtij ligji. Hartimi i planeve bëhet sipas kërkesave të strategjisë dhe planit të veprimit për biodiversitetin, jo më vonë se 5 vjet pas regjistrimit. Kërkesat për hartimin e planeve të veprimit për ruajtjen e llojit miratohen nga ministri.

6. Ministria, nëpërmjet rrjetit të inventarizimit dhe monitorimit të diversitetit biologjik, bashkërendon punën për kërkimin, inventarizimin dhe monitorimin e zbatimit të statusit të ruajtjes së llojeve të regjistruara.

Neni 27

Masa të përkohshme për mbrojtjen dhe menaxhimin

Për llojet veçanërisht të mbrojtura me një status të pafavorshëm ruajtjeje, ministria dhe organet shtetërore përkatëse marrin masat e domosdoshme paraprake për mbrojtjen dhe menaxhimin para regjistrimit të tyre në regjistër dhe para hartimit të planeve të veprimit për ruajtjen e llojit.

Neni 28

Masat për mbrojtjen dhe menaxhimin vullnetar

Pronarët privatë ose grupe të tjera të interesuara mund të lidhin marrëveshje me organin shtetëror përkatës, për të mbrojtur dhe administruar një pronë, me ndihmën teknike, financiare dhe organizative të shtetit, për t'i siguruar llojit veçanërisht të mbrojtur status të favorshëm ruajtjeje.

KREU VI

RACAT DHE VARIETETET AUTOKTONE, TË RËNDËSISHME PËR USHQIM DHE

BUJQËSI

Neni 29

Ruajtja dhe përdorimi

1. Organet shtetërore, organizatat jofitimprurëse dhe personat fizikë dhe juridikë, publikë ose privatë, ruajnë dhe përdorin në mënyrë të qëndrueshme racat dhe varietetet autoktone, të rëndësishme për ushqim dhe bujqësi, në kushtet in-situ dhe ex-situ.

2. Organet e pushtetit qendror dhe vendor krijojnë lehtësitë dhe mbështesin programet për ruajtje dhe kërkime in-situ dhe ex-situ për racat dhe varietetet e rëndësishme për ushqim dhe bujqësi. Metodatat e ruajtjes ex-situ përdoren si metoda plotësuese për ruajtjen in-situ.

3. Ruajtja dhe përdorimi i qëndrueshëm i racave dhe i varieteteve autoktone, të rëndësishme për ushqim dhe bujqësi, janë pjesë e strategjive, planeve, programeve dhe vendimmarrjeve, në nivel kombëtar dhe vendor.

Neni 30

Identifikimi

1. Racat dhe varietetet autoktone të rëndësishme për ushqim dhe bujqësi identifikohen në kushtet e tyre in-situ dhe ex-situ.

2. Identifikimi kryhet në bazë të të dhënave të reja dhe ekzistuese, të siguruar nga strategjia e plani i veprimit të biodiversitetit, nga rrjeti i inventarizimit dhe monitorimit të biodiversitetit, si dhe nga burime ndërkombëtare.

3. Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mban regjistrin e racave dhe të varieteteve autoktone të rëndësishme për ushqim dhe bujqësi.

4. Formati, kriteret e regjistrimit e të çregjistrimit, si dhe rregullat për administrimin dhe shfrytëzimin e regjistrave, miratohen me udhëzim të Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

Neni 31

Masat e menaxhimit

1. Për ruajtjen dhe përdorimin e qëndrueshëm të racave dhe të varieteteve autoktone, të rëndësishme për ushqim dhe bujqësi, të regjistruara në regjistër, Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit harton politika kombëtare të integruara, të cilat miratohen nga Këshilli i Ministrave brenda 5 vjetëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

2. Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, nëpërmjet rrjetit të inventarizimit dhe monitorimit të biodiversitetit, bashkërendon punën për kërkimin, inventarizimin dhe monitorimin, për të mbështetur ruajtjen dhe përdorimin e qëndrueshëm të racave dhe varieteteve autoktone, të rëndësishme për ushqim dhe bujqësi.

3. Përdorimi për qëllime fitimi i një varieteti autokton nuk mund të bëhet pa miratimin e pronarit të tij.

KREU VII

LLOJET E HUAJA DHE LLOJET E HUAJA INVAZIVE

Neni 32

Importimi dhe introduktimi

1. Importimi ose introduktimi i qëllimshëm i llojeve të huaja ose i llojeve të huaja invazive në mjediset tokësore, ujore ose detare të Republikës së Shqipërisë bëhet vetëm me

autorizimin e lëshuar nga organi përkatës dhe pas marrjes së lejes mjedisore.

2. Ministri jep leje mjedisore për importim ose introduktim të qëllimshëm vetëm kur aplikuesi, nëpërmjet njohjes e vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe dokumenteve të tjera, provon se një lloj i huaj apo invaziv nuk do të ndikojë negativisht në mjedis, në shëndetin e njeriut, si dhe në zhvillimin e qëndrueshëm.

3. Vlerësimi mjedisor duhet të paktën:

- a) të bëhet për çdo rast konkret, përpara futjes së tij në vendin tonë;
- b) të bëhet me metoda shkencore;
- c) të bazohet në teknika të njohura vlerësimi;
- ç) të mbështetet në udhëzime të njohura ndërkombëtare.

4. Në aplikimin për t'u pajisur me leje mjedisore përfshihen:

- a) masat për menaxhimin dhe kontrollin e rreziqeve të identifikuara;
- b) një program monitorimi;
- c) një plan për menaxhimin e pasojave të padëshirueshme apo situatat emergjente;
- ç) një garanci financiare për të përballuar pasojat e padëshirueshme apo situatat emergjente.

5. Llojet e huaja, përpara introduktimit të lejuar të tyre, ose produktet që ato përmbajnë u nënshtrohen provave të nevojshme.

6. Për të gjithë organizmat që merret leje mjedisore bëhet regjistrimi në regjistr të hapur për publikun. Ministri, me urdhër, miraton formatin, kriteret e regjistrimit e të çregjistrimit dhe rregullat e administrimit të këtij regjistri.

7. Këshilli i Ministrave, brenda 5 vjetëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, me propozimin e ministrit, miraton listën e llojeve të huaja ose llojeve të huaja invazive dhe përcakton procedurat për ndalimin dhe/ose futjen e tyre në pikat doganore të vendit.

Neni 33

Asgjësimi, kontrolli ose frenimi

1. Ministri dhe ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit urdhërojnë asgjësimin ose frenimin e përhapjes së llojeve të huaja dhe llojeve të huaja invazive, kur ato janë të dëmshme apo potencialisht të dëmshme, të futura me ose pa qëllim.

2. Shpenzimet për masat e marra për asgjësimin, kontrollin, frenimin dhe për riparimin e dëmtimeve mjedisore, mbulohen nga personat juridikë dhe fizikë, përgjegjës për futjen e këtyre llojeve.

3. Ministria bashkërendon punën për hartimin e planeve dhe të masave për asgjësimin dhe kontrollin, ku përfshihen edhe masat për ndërgjegjësimin e publikut për llojet e huaja dhe llojet e huaja invazive të dëmshme, që janë introdiktuar.

Neni 34

Njoftimi i shteteve të tjera dhe këshillimi me to

1. Ministria njofton shtetet e prekura ose potencialisht të prekura, si dhe organizatat përkatëse ndërkombëtare, kur në territorin e Republikës së Shqipërisë ndodh apo mund të ndodhë një transport ndërkufitar i llojit të huaj dhe/ose lloji të huaj invaziv që mund të ketë ndikime negative në shtete të tjera apo në një sipërfaqe jashtë kufijve të çdo juridiksioni kombëtar.

2. Njoftimi përmban:

- a) të dhëna për rreziqet e mundshme, që lidhen me introduktimin, lëvizjen dhe masat për menaxhimin e rrezikut të mundshëm;
- b) një pikë kontakti për komunikime të mëtejshme;
- c) çdo të dhënë tjetër që është e vlefshme.

3. Ministria, në të gjitha rastet, këshillohet me shtetet e prekura apo potencialisht të

prekura, me qëllim që ato të ndërmarrin veprimet e nevojshme dhe masat e sigurimit.

Neni 35

Planifikimi për llojet e huaja dhe llojet e huaja invazive

1. Ministria, nëpërmjet rrjetit kombëtar për inventarizimin dhe monitorimin e biodiversitetit, bashkërendon procesin e vlerësimit të kërcënimeve ndaj mjedisit dhe zhvillimit të qëndrueshëm nga llojet e huaja dhe llojet e huaja invazive, në sipërfaqet tokësore, ujore dhe detare të Republikës së Shqipërisë, brenda 5 vjetëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

2. Nëpërmjet vlerësimit identifikohen:

- a) llojet e huaja dhe llojet e huaja invazive në Republikën e Shqipërisë;
- b) niveli i kërcënimeve për mjedisin dhe zhvillimin e qëndrueshëm;
- c) rrugët e futjes;
- ç) masat për të parandaluar futjet e ardhshme ose për të zhdukur dhe kontrolluar llojet e huaja ekzistuese apo llojet e huaja invazive të identifikuara;
- d) të dhëna të tjetra të nevojshme.

3. Të dhënat përdoren për hartimin e politikave, planeve, programeve dhe veprimtarive për të rregulluar apo administruar rrugët e identifikuara, duke kontrolluar, kufizuar ose asgjësuar llojet e huaja dhe llojet e huaja invazive, kërcënuese apo të dëmshme për mjedisin.

Neni 36

Riintroduktimi i llojeve të huaja dhe i llojeve të huaja invazive

1. Riintroduktimi i llojeve, për t'u kthyer popullatave të tyre mundësinë për të jetuar, ku përfshihen përpjekjet për ripopullim, bëhet vetëm me leje mjedisore ose me miratimin e Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

2. Riintroduktimi lejohet në zonat e mbrojtura, ekosistemet, habitatet e peizazhet veçanërisht të mbrojtura, me kusht që të mos ndikojë negativisht në biodiversitet dhe në mjedisin pritës.

3. Riintroduktimi realizohet sipas rregullave të njohura ndërkombëtare dhe planit të veprimit të llojit ose instrumenteve të tjera menaxhuese.

KREU VIII RUAJTJA EX-SITU

Neni 37

Ruajtja

1. Metodat e ruajtjes ex-situ të llojeve dhe burimeve gjenetike plotësojnë metodat e ruajtjes in-situ.

2. Organet dhe institucionet shtetërore, në zbatim edhe të kërkesave të ligjit nr.8732, datë 24.1.2001 "Për materialin mbjellës bimor", marrin masat dhe krijojnë kushtet e nevojshme për mirëmbajtjen dhe ruajtjen ex-situ të llojeve dhe burimeve të tyre gjenetike.

Neni 38

Planifikimi

Ministria, në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe me institucionet kërkimore-shkencore, ndjek dhe bashkërendon procesin e vlerësimit për ruajtjen ex-situ, nëpërmjet të cilit sigurohen të dhënat e nevojshme, që shërbejnë për politikën, planet dhe programet për ruajtjen e biodiversitetit.

KREU IX
VEPRIMTARI KËRKIMORE QË LIDHEN ME BIODIVERSITETIN

Neni 39
Programet kërkimore

Organet shtetërore përgjegjëse mbështesin dhe përkrahin institucionet kërkimore-shkencore, publike dhe private, për hartimin e programeve kërkimore që mbështesin studimin, koleksionimin e burimeve gjenetike, ruajtjen e biodiversitetit dhe përdorimin e qëndrueshëm të përbërësve të tij.

Neni 40
Vlerësimi

Ministria, në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, brenda 4 vjetëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, kryen vlerësimin e veprimtarive kërkimore për diversitetin biologjik. Vlerësimi do të shërbejë për rishikimin e strategjisë dhe planit të veprimit të biodiversitetit, si dhe do të mbështesë zhvillimin e rrjetit të inventarizimit dhe monitorimit të diversitetit biologjik.

Neni 41
Leja për veprimtaritë që shfrytëzojnë dhe përdorin diversitetin biologjik

1. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, veprimtaritë që shfrytëzojnë dhe përdorin elemente të diversitetit biologjik dhe të përbërësve të tij do të pajisen me leje mjedisore në rastet kur:

a) veprimtaria kërkimore është në përputhje me kërkesat e këtij ligji;
b) janë siguruar informacione për personat juridikë dhe fizikë, që do të kryejnë kërkime, për përdorimin e mëvonshëm të materialeve kërkimore, objekt studimi, si dhe informacione të tjera shoqëruese;

c) parashikohet se veprimtaria kërkimore do të ketë ndikim negativ në diversitetin biologjik.

2. Përparësi u jepet veprimtarive kërkimore, që ndikojnë në masat e ruajtjes dhe të përdorimit të qëndrueshëm, si dhe në rrjetin e inventarizimit dhe monitorimit të biodiversitetit.

3. Për përdorimet e mëvonshme të materialit gjenetik, të molekulave biologjike të lidhura me materialin e mbledhur, leja kushtëzon që këto të bëhen me pëlqimin e ministrisë dhe/ose të pronarit, dhe do t'u nënshtrohen kushteve për ndarjen e përfitimeve.

4. Materialet e mbledhura si pjesë e veprimtarive kërkimore mbeten pronë e Republikës së Shqipërisë ose pronë e pronarit prej të cilit janë mbledhur fillimisht dhe kthehen me përfundimin e veprimtarisë kërkimore, nëse nuk është rënë dakord ndryshe. Transferimi i materialeve palëve të tjera, pa pëlqimin e ministrisë dhe/ose të pronarit, është i ndaluar. Transferimi i materialit bëhet me marrëveshje.

5. Kur veprimtaritë kërkimore janë propozuar nga persona juridikë dhe fizikë të huaj, leja, përveç të tjerave, përmban edhe këto kushte:

a) ndarjen ose përdorimin e mëvonshëm të materialeve kërkimore ndërmjet studiuesve, vendas e të huaj, duke u mbështetur në kushtet e vendosura paraprakisht në kontratë dhe në bazë të rezultateve përfundimtare;

b) të drejtën që Republika e Shqipërisë t'i shfrytëzojë a përdorë kampionet ose produktin e arritur, si dhe të dhënat e mbledhura nëpërmjet këtyre veprimtarive;

c) vlerësimin e të dhënave për zyrtarizimin e tyre;

ç) pëlqimin e dhënë nga ministria dhe/ose institucioni përgjegjës respektiv, që të dhënat e

rezultateve të kërkimeve të pasqyrohen në rrjetet ndërkombëtare të informacionit.

KREU X
NDARJA E PËRFITIMEVE NGA PËRDORIMI I MATERIALIT GJENETIK
DHE I MOLEKULAVE TË TJERA BIOLOGJIKE

Neni 42

Mbledhja dhe përdorimi i materialeve biologjike dhe i kampioneve të mjedisit nga burime in-situ

1. Mbledhja nga burime in-situ dhe përdorimi i sasive të konsiderueshme të bimëve, kafshëve apo materialit mikrobik, të materialit gjenetik apo të molekulave të tjera biologjike, si dhe të dhënave shoqëruese janë të ndaluara pa lejen mjedisore.

2. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, veprimtaritë e përmendura në pikën 1 të këtij neni do të pajisen me lejen mjedisore kur:

a) është siguruar informacioni i plotë për personat juridikë dhe fizikë, që kërkojnë materialet për veprimtaritë e propozuara dhe për përdorimin e mëvonshëm të materialeve që duhen mbledhur;

b) veprimtaria mbledhëse nuk është e ndaluar me ligj;

c) pronarët e materialit, të cilëve u është dhënë informacion i plotë për veprimtarinë e propozuar e për përdorimet e mëvonshme, kanë dhënë pëlqimin paraprak, që lidhet me aksesin dhe përdorimin e çdo të dhëne shoqëruese;

ç) është rënë dakord për kushtet e përdorimit të mëvonshëm të materialeve dhe për ndarjen e përfitimeve, monetare dhe jomonetare, me Republikën e Shqipërisë ose me pronarët privatë.

3. Materialet e mbledhura, si pjesë e veprimtarive kërkimore, mbeten pronë e Republikës së Shqipërisë ose e pronarit nga i cili ato u mbledhën fillimisht. Ndalohet transferimi i materialeve dhe i të dhënave shoqëruese palëve të treta, pa pëlqimin e ministrisë ose të pronarit.

4. Eksporti i materialeve ose i kampioneve të mbledhura nga burimet in-situ dhe i të dhënave shoqëruese është i ndaluar nëse personi juridik a fizik nuk është pajisur me leje mjedisore për veprimtarinë mbledhëse.

Neni 43

Përdorimi i materialeve biologjike dhe i kampioneve të mjedisit nga burime ex-situ

1. Përdorimi i sasive të pakta të bimëve, kafshëve, materialit mikrobik, gjenetik apo i molekulave të tjera biologjike, që ato përmbajnë, të marra nga burime ex-situ në pronësi apo financim publik, si dhe i të dhënave shoqëruese bëhen me marrëveshje për transferimin e materialit të siguruar nga këto burime.

2. Marrëveshja për transferimin e materialit nga një burim ex-situ bëhet kur:

a) veprimtaria është e lejuar nga ligji;

b) janë siguruar të dhëna të plota për personat juridikë dhe fizikë, që i kërkojnë materialet dhe për përdorimin e mëvonshëm të tyre;

c) është rënë dakord për kushtet e përdorimit të mëvonshëm të materialeve dhe për ndarjen e përfitimeve, monetare dhe jomonetare, me Republikën e Shqipërisë ose me pronarin privat;

ç) është dhënë çdo e dhënë tjetër që kërkohet nga ministria apo nga një organ tjetër shtetëror.

3. Materialet e përfituara dhe të dhënat shoqëruese mbeten pronë e Republikës së Shqipërisë ose e pronarit nga i cili ato u mbledhën ose u morën fillimisht. Transferimi i materialeve dhe i të dhënave shtesë palëve të treta bëhet në bazë të normave ndërkombëtare dhe

me pëlqimin e pronarit, si dhe me marrëveshje për transferimin e materialit.

4. Eksporti i materialeve apo i kampioneve dhe i të dhënave shoqëruese nga burimet ex-situ në pronësi publike, pa marrëveshjen për transferimin e materialit, është i ndaluar.

5. Ministria harton marrëveshjen tip për transferimin e materialit për përdorim nga të gjitha burimet ex-situ në pronësi apo financim publik.

Neni 44

Përdorim i kushtëzuar i llojeve

Organet shtetërore, që lëshojnë autorizimin për shfrytëzimin ose përdorimin e llojeve, i kërkojnë përdoruesit lejen mjedisore për përdorimin e mëvonshëm të materialit dhe marrëveshjen për ndarjen e përfitimeve monetare dhe jomonetare të përcaktuara në shkronjën “c” të pikës 2 të nenit 43 të këtij ligji.

KREU XI

DIJET, RISITË DHE PRAKTIKAT E KOMUNITETEVE VENDORE

Neni 45

Ruajtja dhe mirëmbajtja

1. Dijet, risitë dhe praktikat e komuniteteve vendore për ruajtjen e biodiversitetit dhe përdorimin e qëndrueshëm të përbërësve të tij respektohen, ruhen dhe promovohen. Ato përdoren për të plotësuar praktikat për ruajtjen dhe përdorimin e qëndrueshëm të diversitetit biologjik në Republikën e Shqipërisë.

2. Mbledhja dhe dokumentimi i dijeve dhe i praktikave nga komunitetet ose individët vendorë kryhen vetëm me pëlqimin e tyre dhe kur ata e dinë se si do të përdoren këto materiale.

3. Komunitetet ose individët brenda komunitetit kanë të drejtë të përfitojnë nga përdorimi tregtar ose jotregtar i dijeve dhe i praktikave të tyre.

KREU XII

PJESËMARRJA E PUBLIKUT

Neni 46

Detyrat e organeve shtetërore

1. Organet shtetërore, qendrore dhe vendore, sigurojnë mbështetjen e publikut për të ruajtur diversitetin biologjik dhe për t'i përdorur përbërësit e tij në mënyrë të qëndrueshme.

2. Organet shtetërore sigurojnë që publiku dhe shoqëria civile:

a) të vihen në dijeni gjerësisht për diversitetin biologjik dhe përbërësit e tij nëpërmjet botimit të të dhënave dhe programeve të ndërgjegjësimit e të edukimit;

b) të përfshihen në vendimmarrje për diversitetin biologjik dhe përbërësit e tij, që përfshin edhe proceset e vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe të vlerësimit strategjik mjedisor;

c) t'u sigurohet e drejta për t'iu drejtuar gjykatës për çështjet që lidhen me ruajtjen e diversitetit biologjik dhe përdorimin e qëndrueshëm të përbërësve të tij.

Neni 47

Pjesëmarrja dhe vënia në dijeni e publikut

1. Politikat, programet, regjistrat dhe vendimmarrjet realizohen në këshillim me organet e tjera shtetërore, me organizatat jofitimprurëse dhe me publikun. Mendimet e tyre vlerësohen nga vendimmarrësit përpara marrjes së vendimeve.

2. Organet shtetërore sigurojnë se dokumentet dhe instrumentet, që lidhen me biodiversitetin, të përcaktuara në këtë ligj apo në ligje të tjera, të jenë të disponueshme për publikun.

3. Ministri shpall Ditën Kombëtare të Biodiversitetit, në përputhje me datën ndërkombëtare të biodiversitetit, të vendosur nga Konventa e Diversitetit Biologjik dhe miraton kalendarin kombëtar të mjedisit.

Neni 48

Edukimi dhe përgatitja

Ministria, në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, bashkërendon integrimin e parimeve të ruajtjes së biodiversitetit në programet shkollore, për edukimin dhe përgatitjen e nxënësve dhe të studentëve.

KREU XIII KONTROLLI

Neni 49

Kontrolli

1. Për ruajtjen e biodiversitetit dhe të përbërësve të tij, në zbatimin e kërkesave të këtij ligji, ushtrojnë kontroll Inspektorati i Mjedisit, Policia e Shtetit, Policia e Shërbimit Pyjor, Inspektorati i Peshkimit, Inspektorati i Mbrojtjes së Bimëve, Inspektorati Zooveterinar dhe inspektoratet e tjera, që ushtrojnë veprimtari në bazë të ligjeve, në mbështetje të të cilave janë krijuar.

2. Kontrollat shërbejnë për verifikimin e zbatimit të legjislacionit, që mbron biodiversitetin, për rishikimin ose heqjen e lejeve mjedisore dhe për marrjen e masave të përcaktuara në këtë ligj.

3. Kontrollat ushtrohen mbi veprimtaritë që kanë ndikime mbi biodiversitetin dhe përbërësit e tij. Pas kontrollit, në përputhje me dëmtimet e biodiversitetit, vendoset mbyllja a pezullimi i pjesshëm ose i plotë i veprimtarisë, duke përcaktuar edhe masat për rehabilitimin e gjendjes.

KREU XIV MASAT EKONOMIKE DHE FINANCIARE NË MBËSHTETJE TË BIODIVERSITETIT

Neni 50

Masat ekonomike

Ministria bashkërendon punën për hartimin e masave sektoriale dhe ndërsektoriale:

a) nxitjet e duhura ekonomike për veprimtarinë e dobishme për ruajtjen e biodiversitetit ose përdorimin e tij në mënyrë të qëndrueshme për të:

i) ruajtur diversitetin biologjik, ekosistemet, habitatet dhe peisazhet veçanërisht të mbrojtura, llojet veçanërisht të mbrojtura dhe llojet e rëndësishme për ushqim e bujqësi;

ii) kryer transferimet teknologjike që nuk dëmtojnë mjedisin dhe që mbrojnë biodiversitetin;

b) ndaluese të duhura, përfshirë sanksionet për ruajtjen e diversitetit biologjik për:

i) veprimtari, që nuk përdorin në mënyrë të qëndrueshme përbërësit e diversitetit biologjik;

ii) përdorimin e teknologjive që nuk janë të pajtueshme me konceptet e mbrojtjes së

mjedisit dhe/ose kërcënojnë diversitetin biologjik;

c) që sigurojnë identifikimin dhe heqjen ose zbutjen e masave ekonomike e të masave të tjera, që nxisin ose ulin humbjet e diversitetit biologjik.

Neni 51

Fondet për mjedisin

Ministria bashkërendon punën për mënyrën e financimit për mbrojtjen e mjedisit dhe të diversitetit biologjik, si dhe përfshirjen në Buxhetin e Shtetit, si zë të veçantë, të fondeve për këtë qëllim.

Neni 52

Ndarja e burimeve financiare

1. Ministria, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave, bashkërendon punën për sigurimin e burimeve financiare nga Buxheti i Shtetit dhe nga donatorë të huaj për zbatimin e masave të parashikuara në nenin 50 të këtij ligji dhe për zbatimin tërësor të ligjit.

2. Institucionet qendrore dhe organet e qeverisjes vendore, në bashkëpunim me ministrinë, planifikojnë një fond në buxhetin vjetor, i cili do të përdoret për të mbështetur zbatimin e detyrave që u ngarkon ky ligj.

KREU XV SANKSIONET

Neni 53

Përgjegjësitë

1. Çdo organ shtetëror, organizatë shoqërore, person juridik ose fizik, që dëmton ose kërcënon biodiversitetin, përgjigjet për dëmtimet dhe përballon koston e ripërtëritjes e të rehabilitimit të përbërësve të prekur të biodiversitetit.

2. Për shkeljet e kryera nga një person juridik, mbajnë përgjegjësi edhe drejtuesi dhe/ose nëpunësi që ishte ose që duhet të ishte në dizeni për shkeljen.

Neni 54

Sanksionet

1. Kur shkeljet e këtij ligji përbëjnë vepër penale, Inspektorati i Mjedisit dhe organet e tjera të kontrollit, të përmendura në pikën 1 të nenit 49 të këtij ligji, bëjnë kallëzim për ndjekje penale ndaj personave përgjegjës për shkeljen.

2. Kur nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative shkeljet e mëposhtme:

a) kapja, marrja, mbajtja dhe përdorimi i llojeve të kafshëve dhe i bimëve të mbrojtura;

b) shfrytëzimet apo përdorimet e reja të individëve të llojeve të kafshëve dhe bimëve, që cenojnë statusin e ruajtjes së llojeve të kërcënuara, kur nuk janë miratuar nga ministri dhe nuk janë pajisur me leje mjedisore;

c) shfrytëzimi ose përdorimi i rastësishëm i llojeve veçanërisht të mbrojtura;

ç) përdorimi për qëllime fitimi i një varieteti autokton pa miratimin e pronarit të tij;

d) importimi ose introduktimi i qëllimshëm i llojeve të huaja ose llojeve të huaja invazive në mjedise tokësore, ujore ose detare të Republikës së Shqipërisë, pa autorizimin e organit përkatës dhe pa leje mjedisore;

dh) mospajisja, me hyrjen në fuqi të ligjit, me leje mjedisore e veprimtarive që

shfrytëzojnë diversitetin biologjik dhe përbërësit e tij, sipas pikës 1 të nenit 41 të këtij ligji;

e) transferimi i materialit të mbledhur si pjesë e veprimtarive kërkimore palëve të tjera, pa pëlqimin e ministrisë dhe/ose pronarit;

ë) mbledhja nga burime in-situ dhe përdorimi i sasive të shumta të bimëve, kafshëve apo materialit mikrobik, të materialit gjenetik apo molekulave të tjera biologjike, si dhe i të dhënave shoqëruese pa leje mjedisore;

f) mospajisja me leje mjedisore e veprimtarive, sipas pikës 2 të nenit 42 të këtij ligji;

g) eksportimi pa leje mjedisore i materialeve ose kampioneve të mbledhura nga burime in-situ dhe i të dhënave shoqëruese për veprimtaritë mbledhëse;

gj) përdorimi pa marrëveshje i sasive të pakta të bimëve, kafshëve, i materialit mikrobik, gjenetik apo i molekulave të tjera biologjike, që ato përmbajnë, të marra nga burime ex-situ, me pronësi apo financim publik, si dhe i të dhënave për transferimin e materialit të siguruar nga burimet ex-situ;

h) transferimi pa marrëveshje dhe pa pëlqimin e pronarit për transferimin e materialit të përfiturar dhe i të dhënave shtesë palëve të treta;

i) eksportimi pa marrëveshje transferimi i materialeve apo kampioneve dhe i të dhënave shoqëruese nga burime ex-situ në pronësi publike;

j) mbledhja dhe dokumentimi i dijeve dhe praktikave pa pëlqimin e komuniteteve ose të individëve vendorë;

k) shfrytëzimi apo përdorimi i individëve të kafshëve dhe bimëve veçanërisht të mbrojtura, siç përcaktohet në nenin 23 të këtij ligji.

3. Inspektorati i Mjedisit, për kundërvajtjet administrative të parashikuara në pikën 2 të këtij neni, jep dënime me gjobë:

a) për shkeljet e përcaktuara në shkronjat “a”, “b”, “c”, “d”, “dh”, “ë” dhe “j”, nga 300 000 (treqind mijë) lekë deri në 500 000 (pesëqind mijë) lekë;

b) për shkeljet e përcaktuara në shkronjat “ç”, “e”, “g”, “gj”, “h” dhe “i” nga 10 000 (dhjetë mijë) lekë deri në 300 000 (treqind mijë) lekë.

4. Krahas dënimit me gjobë, mund të vendoset edhe sekuestrimi i mjeteve që shkaktojnë dëmtimin ose heqja e lejes mjedisore. Në çdo rast kundërshtimi për zbatimin e këtyre masave, Inspektorati i Mjedisit bashkëpunon me Policinë e Shtetit.

5. Shkeljet e parashikuara në krerët IV, V dhe VI të këtij ligji, përveç gjobave, në të gjitha rastet shoqërohen edhe me konfiskim të materialit biologjik dhe të mjeteve, me të cilat është kryer veprimi i paligjshëm.

Neni 55

Ankimi

Kundër masave administrative, personi juridik a fizik mund të bëjë ankesë te ministri brenda 10 ditëve nga marrja njoftim, i cili përgjigjet brenda 15 ditëve nga marrja e ankimit. Kundër vendimit të ministrit ose kur ky i fundit nuk përgjigjet brenda afatit 15-ditor, mund të bëhet ankim brenda 30 ditëve nga marrja e njoftimit në gjykatën e rrethit ku është bërë kundërvajtja.

Neni 56

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 9 pika 2, 20 pika 2, 31 pika 1 e 32 pika 7 të këtij ligji.

2. Ngarkohen, përkatësisht, Ministri i Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe Ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit të nxjerrin aktet nënligjore në zbatim të neneve 13 pika 6, 16 pika 1, 22 pikat 4 e 5, 26 pikat 1 e 5, 30 pika 4, 32 pika 6 dhe 47 pika 3 të këtij ligji.

3. Ministri propozon dhe miraton akte nënligjore, në zbatim të kompetencave të tij, për përafrimin e legjislacionit shqiptar me atë të Bashkimit European.

Neni 57

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.5007, datë 4.8.2006 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu**